



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA SUPREME E KOSOVËS
VRHOVNI SUD KOSOVA – SUPREME COURT OF KOSOVO

Gjykata Supreme e Republikës së Kosovës

PLANI DHE PROGRAMI I PUNËS Korrik - Dhjetor 2023

Korrik
2023

Ky Plan dhe Program Vjetor i Punës së Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës, është aprovuar në Seancën e Përgjithshme të gjyqtarëve të Gjykatës Supreme, më 26 korrik 2023

FJALA E KRYETARIT

Gjykata Supreme e Kosovës, si institucion më i lartë gjyqësor në vend, është një model për gjykatat e shkallëve më të ulëta. Ne kemi përpara synime të rëndësishme gjatë periudhës gjashtëmujore në vazhdim, për të forcuar dhe avancuar sistemin gjyqësor në Kosovë. Në këtë drejtim, dua të ndaj disa refleksione në lidhje me këto synime dhe sfidat përpara nesh.

Një synim i madh është përmirësimi i efikasitetit të punës së gjykatës. Gjatë kohës së kaluar kemi arritur progres të konsiderueshëm në këtë drejtim, dhe synojmë të vazhdojmë në rrugën e suksesit.

Një synim tjetër i rëndësishëm është përmirësimi i transparencës dhe llogaridhënies para publikut. Ne besojmë në të drejtën e publikut për të qenë i informuar rreth punës dhe veprimtarisë së gjykatës. Prandaj, do të vazhdojmë të publikojmë aktgjykime dhe vendime, duke siguruar qasje të hapur për të gjithë qytetarët. Gjithashtu, do të vazhdojmë të komunikojmë rregullisht me mediat dhe organizatat joqeveritare për të ndarë informacione dhe për të pranuar sugjerime dhe vlerësime konstruktive nga ana e tyre.

Në fushën e politikës ndëshkimore, synimi ynë është të arrijmë unifikimin e politikave dhe praktikave në të gjithë vendin. Ne do të punojmë me angazhim të plotë për të përmirësuar politikën ndëshkimore dhe për të garantuar zbatimin e barabartë dhe të drejtë të ligjit për të gjithë qytetarët. Do të analizojmë rastet e kthyera në rigjykim nga Gjykata Supreme dhe do të hartojmë buletine për praktikën gjyqësore të gjykatës, duke përfshirë vendimet nga viti 2018, me qëllim të përmirësimit të praktikës së gjyqësorëve në të ardhmen.

Si kryetar i Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës, unë angazhohem të bashkëpunoj me të gjithë stafin e gjykatës dhe të ndihmoj në përmirësimin e efikasitetit dhe cilësisë së punës sonë.

Gjithashtu, do të vazhdojmë të përkushtohemi për transparencë në gjykatë, duke siguruar që qytetarët të kenë besim të plotë në drejtësinë tonë. Ne do të ndërtojmë një lidhje të fortë me publikun, duke komunikuar rregullisht me mediat dhe organizatat joqeveritare, dhe duke marrë parasysh sugjerimet dhe vlerësimet e tyre.

Në këtë periudhë, do të punojmë për të forcuar bashkëpunimin tonë me institucionet relevante, duke përfshirë Ambasadën Amerikane në Kosovë dhe Komisionin Konsultativ për Politikë Ndëshkimore.

Bashkëpunimi i mirëfilltë dhe koordinimi me këto institucione do të na ndihmojë të avancojmë politikën ndëshkimore dhe të sigurojmë një sistem gjyqësor të fortë dhe të besueshëm.

Përmbyllja e këtyre synimeve do të shërbejë për të rritur besimin e qytetarëve në drejtësi dhe për të përmirësuar funksionimin e sistemit gjyqësor në Kosovë. Unë jam i vendosur të kryej detyrën time me përgjegjësi dhe ndërgjegje të plotë ndaj rëndësisë së rolit të Gjykatës Supreme në drejtësi dhe shtetin tonë.

Fejzullah Rexhepi

Kryetar i Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës

Plani dhe Programi i Punës (korrik-dhjetor 2023)

PËRMBLEDHJE

Kryetari i Gjykatës Supreme ka përcaktuar Planin e Punës dhe Programin për unifikimin e praktikës gjyqësore në vend, si dhe zgjidhjen efikase të lëndëve, për periudhën gjashtë mujore (korrik-dhjetor) të vitit 2023.

Ky Plan i punës dhe programi përfshin orarin vjetor të kolegjeve gjyqësore të caktuara nga kryetari i gjykatës, si dhe grupet punuese që do të shqyrtojnë politikën ndëshkimore të zbatuar nga gjykatat e shkallëve më të ulëta gjyqësore. Në të njëjtën kohë, ky plan program paraqet tërësinë e aktiviteteve që do të zbatohen gjatë gjashtë mujorit të vitit 2023, veçanërisht në periudhën korrik-dhjetor. Qëllimi kryesor i këtij dokumenti është të caktojë prioritetet e punës dhe të adresojë përgjegjësinë për çështjet e caktuara, planet dhe agjendat e gjykatës.

Caktimi i kolegjeve gjyqësore të cilët përfshihen në orar dhe grupet punuese që shqyrtojnë politikën ndëshkimore të gjykatave të shkallëve më të ulëta gjyqësore ndihmon në theksimin e organizimit dhe përfshirjes së strukturave të ndryshme të sistemit gjyqësor. Ky caktim do të jetë e dobishme për të kuptuar se si plani dhe programi i punës do të realizohen në praktikë.

Gjithashtu, plani dhe programi i punës synojnë të sigurojnë unifikimin e praktikës gjyqësore në vend, duke adresuar çështjet specifike dhe duke vendosur prioritetet e punës së gjykatës. Kjo përpjekje për unifikim të praktikës gjyqësore dhe vendosje e prioritetit në punën e gjykatës synon të arrijë një nivel të lartë të konsistencës në vendimet gjyqësore në gjithë sistemin gjyqësor. Përmes adresimit të çështjeve specifike dhe përcaktimit të prioritetëve të punës, plani dhe programi i punës synojnë të sigurojnë që gjykatat të trajtojnë rastet dhe çështjet në një mënyrë të njëjtë dhe konsistente. Në këtë mënyrë, synohet të kemi një sistem gjyqësor të përshtatshëm dhe të besueshëm, që i plotëson detyrat e tij me drejtësi dhe barazi për të gjithë qytetarët.



PLANI I PUNËS

(korrik-dhjetor 2023)

I. Organizimi i punës në Gjykatën Supreme

Me organizimin e punës së gjyqtarëve dhe administratës së Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës udhëheqë kryetari i gjykatës, Fejzullah Rexhepi. Në mungesë të kryetarit me organizimin e punës së gjyqtarëve dhe administratës do të udhëheq nënkryetarja (e propozuar Mejreme Memaj). Me organizimin e punës së Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme udhëheq – u.d. gjyqtari mbikëqyrës Sahit Sylejmani.

Me menaxhimin e punëve administrative, teknike dhe sigurimin e objektit, merret administratorja e Gjykatës, Ajna Gashi, ndërsa për DHPGJS, administratori Isuf Behluli.

II. Funkcionet gjyqësore dhe udhëheqja e degëve të Gjykatës

Gjykata Supreme shqyrton dhe gjykon lëndët në kolegji me nga tre (3) gjyqtarë profesionist, me përjashtim kur me ligj parashihet një numër më i madh i gjyqtarëve.

Në kuadër të Gjykatës Supreme funksionojnë degët gjyqësore:

Dega penale,

Dega civile,

Dega administrative, si dhe

Praktika gjyqësore.

Aktualisht, Gjykata Supreme e Republikës së Kosovës në përbërje të vet ka 16 gjyqtarë, përfshirë kryetarin, të cilët do të punojnë në kuadër të degëve si vijon:



Dega penale

- Mejreme Mema
- Afrim Shala
- Valdete Daka
- Agim Maliqi
- Rasim Rasimi


Në Degën penale, udhëheqëse caktohet gjyqtarja Mejreme Memaj, zëvendës, gjyqtari Agim Maliqi.

Në Degën Civile do të punojnë këta gjyqtarë:



- Gjyqtari Shukri Sylejmani caktohet udhëheqës i degës civile-ekonomike, ndërsa zëvendës, Beshir Islami.

Në Degën administrative do të punojnë:



Në degën administrative janë të caktuar gjyqtarët Nebojsa Boriqiq dhe Ragip Namani si bartës të lëndëve, ndërsa anëtar të kolegjit do të jenë edhe gjyqtarët tjerë të degës civile sipas përzgjedhjes së SMIL-it, ndërsa në lëndët pa SMIL antarë do të jetë gjyqtari Shukri Sylejmani. Në rast të zgjedhjeve të jashtëzakonshme në vend, ankesat e pranuar nga palët ndaj vendimeve të PZAP-së, do t'ju ndahen të gjithë gjyqtarëve të degës civile, shkak i afateve të shkurta ligjore për trajtimin e tyre.

Për degën administrative, udhëheqës caktohet gjyqtari Nebojsa Boricić, ndërsa zëvendës gjyqtari, Ragip Namani.

Në Kolegjin e Apelit të Gjykatës Supreme do të punojnë:

- **Beshir Islami**
- **Ragip Namani**
- **Nenad Lazic**

- Ankesat në shkallë të tretë i kryeson kryetari apo nën kryetarja e Gjykatës.

Udhëheqësit e degëve do t'i raportojnë kryetarit të gjykatës për punën e degëve gjyqësore, së paku njëherë në tre (3) muaj. Pjesë e raporteve të udhëheqësve, duhet të jenë edhe raportet e gjyqtarëve përgjegjës të degëve.

III. Përbërja e Kolegjeve

Të gjitha çështjet në Degën Penale të Gjykatës Supreme gjykohen nga trupi gjykues prej tre (3) gjyqtarësh profesional, nga të cilët njëri duhet të jetë kryetar i trupit gjykues.

Të gjitha çështjet në Degën Civile gjykohen nga tre (3) gjyqtarë, përveç nëse me ligj parashihet ndryshe. Kolegje prej tre gjyqtarësh parashihen edhe për degën administrative dhe për lëndët në Kolegjin e Apelit.

Në çështjet ku palë janë të miturit, udhëheq gjyqtari Afrim Shala.

Plani dhe orari vjetor i Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme nuk është përfshirë në këtë material.

IV. Ndarja e lëndëve

Lëndët në Gjykatë Supreme ndahen në mënyrë elektronike përmes Sistemit për Menaxhimin e Lëndëve – SMIL. Nëse gjyqtarit, të cilit i është caktuar lënda duhet përjashtuar nga arsyet e ndryshme, kërkesa për përjashtim duhet të bëhet tek kryetari. Në rastet kur paraqitet nevoja e ndryshimit të kolegjit të paracaktuar me SMIL, kërkesa bëhet tek kryetari për të gjitha ndryshimet e kolegjit, dhe ndryshim bëhet përmes sistemit SMIL.

V. Orari vjetor i punës së Gjyqtarëve të Gjykatës Supreme

Kryetari i Gjykatës Supreme Fejzullah Rexhepi, në bazë të Ligjit për Gjykatat e Rregullta të Kosovës neni 25 par 7, me datë **26 korrik 2023** cakton ORARIN VJETOR TË PUNËS TË GJYQTARËVE TË GJYKATËS SUPREME TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS PËR PERIUDHËN 01.07.2023 deri 31.12.2023. Ky orar vlen në rastet kur kolegji i çështjeve, nuk është paracaktuar me SMIL.

DEGA PENALE

*Kolegji i parë në çështje penale me mjete të jashtëzakonshme juridike
Seancat e këtij kolegji mbahen të hënave*

1. Valdete Daka, kryetare,

2. Rasim Rasimi, anëtar dhe

3. Mejreme Memaj, anëtare.

*Kolegji i dytë në çështje penale me mjete të jashtëzakonshme juridike.
Seancat e këtij kolegji mbahen të martave*

1. Mejreme Memaj, kryetare,

2. Agim Maliqi, anëtar

3. Afrim Shala, anëtar

Plani dhe Programi i Punës (korrik-dhjetor 2023)

<p style="text-align: center;"><i>Kolegji i parë për paraburgime</i> <i>Kolegji i parë është kujdestar në muajin tek</i></p>
1. Agim Maliqi, kryetar
2. Valdete Daka, anëtare
3. Rasim Rasimi, anëtar.
<p style="text-align: center;"><i>Kolegji i dytë për paraburgime</i> <i>Kolegji i dytë është kujdestar në muajt çift</i></p>
1. Valdete Daka, kryetare,
2. Afrim Shala, anëtar
3. Mejreme Memaj anëtare.
<p style="text-align: center;">KOLEGJI PËR TË MITUR</p>
1. Afrim Shala, kryetar
2. Rasim Rasimi, anëtar
3. Mejreme Memaj, anëtare

Anëtarët e kolegjit rezervë për kolegjin e të treve në lëmin penale

1. Java e I-rë Muhamet Rexha,
2. Java e II-të Shukri Sylejmani,
3. Java e III-të Zenel Leku,
4. Java e IV-të Milena Djeric
5. Java e V-të Nebojsa Boricic,
6. Java e VI -të Rrustem Thaçi,

7. Java e VII- të Beshir Islami

Dega civile
<i>Anëtarët e Kolegjit të parë</i>
1. Shukri Sylejmani, kryetar
2. Beshir Islami, anëtar
3. Nenad Lazić , anëtar
<i>Anëtarët e kolegjit të dytë</i>
1. Muhamet Rexha, kryetar
2. Zenel Leku, anëtar
3. Rrustem Thaqi, anëtar
<i>Anëtarët e kolegjit të dytë</i>
1. Beshir Islami, kryetar
2. Muhamet Rexha, anëtar
3. Milena Djeric, anëtare

Përcaktimi i ndarjes së punës për gjyqtarët e çështjeve civile në rastet e përjashtimit

1. Rrustem Thaqi - Zenel Leku,
2. Shukri Sylejmani – Beshir Islami,
3. Muhamet Rexha – Nenad Lazic

Plani dhe Programi i Punës (korrik-dhjetor 2023)

4. Milena Djeric, në rast nevoje

DEGA ADMINISTRATIVE

Kolegji i parë

Kolegji i parë është kujdestar në muajin tek

1. Nebojsa Boricic, kryetar,

2. Beshir Islami, anëtar

3. Muhamet Rexha, anëtar.

Kolegji i dytë

Kolegji i dytë është kujdestar në muajt çift

1. Ragip Namani, kryetar

2. Shukri Sylejmani, anëtar

3. Zenel Leku, anëtar

Në kolegji vendosen të gjitha lëndët sipas mjeteve juridike të jashtëzakonshme dhe lëndët tjera administrative nëse me këtë orar nuk është përcaktuar që të vendosen në kolegji të veçantë.

Eventualisht nëse Kryetari i kolegjit në çështje administrative përjashtohet për shkaqe procedurale, i njëjti zëvendësohet nga gjyqtari Beshir Islami.

Kolegji për vendosjen në shkallë të tretë (neni 26 par.1.3 të Ligjit për Gjykatat)

Kolegji i parë

1. Mejreme Memaj, kryetare (**neni 26 par 1. gjykata Supreme vendos në shkallë të tretë për ankesat e lejuara me ligj;**)

2. Afrim Shala, anëtar dhe

3. Rasim Rasimi, anëtar
<i>Kolegji i dytë</i>
1. Mejreme Memaj, kryetare
2. Valdete Daka, anëtare dhe
3. Agim Maliqi, anëtar.

*Në mungesë të kryetarit të kolegjit, gjyqtari Afrim Shala zëvendëson kryetarin. Lëndët në kolegji vendosen në përputhje me mjete juridike të jashtëzakonshme, ndërsa lëndët penale të tjera vendosen në kolegji të veçantë vetëm nëse kjo nuk është përcaktuar me orarin e punës. Kryetari i Gjykatës do të përcaktojë një orar të veçantë sipas nevojës për të plotësuar kolegjet për çdo rast konkret.

Në rast përjashtimi të gjyqtarit nga çështja penale, lënda i ndahet në punë gjyqtarit sipas kësaj radhitjeje:

1.Valdete Daka – Afrim Shala,
2. Rasim Rasimi – Agim Maliqi
3. Mejreme Memaj – Agim Maliqi

*Nëse ndonjëri nga gjyqtarët mungon nga kolegji penal për ndonjë arsye, atë e zëvendëson gjyqtari nga kolegji penal tjetër me radhitje të njëjte (p.sh. anëtarin e 3 (tretë) që mungon, e zëvendëson anëtari i 3 (tretë) i kolegjit tjetër e kështu me radhë.

Gjyqtarët e ngarkuar me unifikimin e praktikës gjyqësore, janë të ngarkuar me gjysmën normës. Me rastin e ndarjes së lëndëve gjyqtarët në fjalë nuk ngarkohen me lëndë me radhë si gjithë gjyqtarët tjerë, por nëse ngarkohen një herë në rastin tjetër të radhës së ndarjes së lëndëve nuk përfshihen me gjyqtarët tjerë.

Ky orar i punës do të aplikohet prej datës së aprovimit në Seancën e Përgjithshme të Gjykatës Supreme.

VI. Seancat e përgjithshme të Gjykatës Supreme

Kryetari i gjykatës thërret seancë të përgjithshme për të adresuar kërkesat për mendime juridike, qëndrime parimore dhe udhëzime të nevojshme për unifikimin e praktikës gjyqësore dhe zgjidhjen e dilemave në zbatimin e ligjit.

Kryetari i gjykatës organizon seancën vjetore të gjyqtarëve në fillim të vitit. Në këtë seancë, analizohet puna e vitit të kaluar, vlerësohet funksionimi i gjykatës gjatë këtij periudhe, hartohet plani vjetor i punës për vitin e ardhshëm dhe diskutohen çështje të tjera të caktuara nga kryetari i gjykatës në konsultim me gjyqtarët. Seancat mund të thirren sipas nevojës edhe në kohë të tjera.

Pjesëmarrja në seancat e përgjithshme është e obligueshme dhe rendi i ditës përcaktohet nga kryetari i gjykatës. Asistentja e kryetarit mbështet kryetarin në organizimin dhe zhvillimin e seancave të përgjithshme, njofton gjyqtarët së paku shtatëdhjetë e dy (72) orë përpara seancës dhe i siguron materialet e rëndësishme për mbledhjen. Administratorja e gjykatës ruan procesverbal dokumentacionin për zhvillimin e mbledhjes, i cili paraprakisht u dorëzohet gjyqtarëve për të paraqitur vërejtjet e tyre. Pastaj, procesverbali miratohet në seancën tjetër dhe të gjitha dokumentet e seancave arkivohen në dosje të veçanta.

Kryetari i Gjykatës ka të drejtë të thërret mbledhje të gjyqtarëve ose stafit edhe për të diskutuar çështje të administrimit të gjykatës, organizimin e punës, rezultatet e arritura dhe për të adresuar sfidat dhe problemet e punës.

VII. Orari i Punës dhe Respektimi i Kodit të Mirësjelljes

Orari i punës në gjykatë fillon në ora 08:00 dhe zgjatë deri në ora 16:00, ndërsa pushimi ditor shfrytëzohet nga ora 12:00 deri në ora 13:00, në rast pamundësie të shfrytëzimit të pushimit brenda këtij orari, pushimi ditor mund të shfrytëzohet edhe jashtë këtij orari, por vetëm për të njëjtën ditë.

Të gjithë të punësuarit në Gjykatën Supreme janë të obliguar që gjatë orarit të punës në ushtrimin e pozitës zyrtare, të sillen në mënyrë korrekte, duke respektuar Kodin e Mirësjelljes për Personelin e Administratës Gjyqësore, njëkohësisht Kodin e Etikës Profesionale për Gjyqtarë.

Veshja dhe paraqitja e të gjithë zyrtarëve të gjykatës, duhet të jenë serioze, për ta përfaqësuar sa më denjësisht institucionin në pajtim me legjislacionin në fuqi.

Përdorimi apo aktivitetet e zyrtareve të gjykatës, përfshirë gjyqtarët në rrjetet sociale duhet të jenë të përgjegjshme dhe të paraqiten në mënyrë korrekte, ndërsa vendosja e fotografive dhe postimeve të ndryshme, duhet të jetë e kujdesshme në nivelin e paraqitjeve korrekte.

VIII. Zbatimi i programit TIK/SMIL

Gjykata Supreme është në fazën e implementimit të Sistemit për Menaxhimin Informativ të Lëndëve (TIK/SMIL). Me mbështetjen e zyrtarëve të teknologjisë informative të Gjykatës Supreme të gjitha lëndët ngarkohen në këtë sistem dhe raportet e të gjithë gjyqtarëve të nxjerrën vetëm përmes sistemit SMIL, përfshirë këtu edhe raportet e përgjithshme të gjykatës.

IX. Transparenca dhe llogaridhënia

Me qëllim të rritjes së transparencës dhe llogaridhënies, Gjykata Supreme angazhohet për të informuar publikun rregullisht në lidhje me punën dhe aktivitetet e saj.

Përveç komunikimit me publikun përmes komunikatave të lëshuara nga gjykata, faqja zyrtare e gjykatës do të vazhdojë të jetë burimi kryesor për të ofruar të gjitha informacionet për opinionin publik. Kjo përfshin publikimin e aktgjykimeve dhe aktvendimeve, mendimeve juridike, udhëzimeve dhe dokumenteve tjera relevante të gjykatës. Për të rritur transparencën dhe llogaridhënien, faqja zyrtare e Gjykatës Supreme në rrjetin social Facebook do të shërbejë gjithashtu për të publikuar aktivitetet e gjykatës, vendimet për rastet me interes publik dhe publikimin e dokumenteve me rëndësi.

Këto masa kanë si qëllim të sigurojnë qasje të hapur dhe të plotë për publikun në lidhje me punën dhe vendimet e Gjykatës Supreme, duke ndihmuar në krijimin e një mjedisi më transparent dhe llogaridhënës për të gjithë qytetarët.

X. Administrata Gjyqësore

Me menaxhimin e punëve administrative, teknike dhe sigurimit të objekteve, do të administroi administratorja e Gjykatës Supreme, Ajna Gashi.

Administratorja menaxhon dhe mbikëqyrë funksionet administrative të gjykatës në mënyrë autonome, në bashkëpunim me kryetarin e gjykatës dhe në koordinim me sekretariatit e Këshillit Gjyqësor të Kosovës (KGJK).

Në mungesë të administratores së gjykatës, detyrën e saj e ushtron përkohësisht zyrtarja e lartë ligjore, Vjollca Cenaj, përveç nëse udhëzohet ndryshe nga Kryetari i gjykatës.

**Programi për analizimin e politikës
ndëshkimore dhe praktikës gjyqësore,
për periudhën korrik – dhjetor 2023**

1. Prioritetet dhe Rekomandimet për Degët Gjyqësore për periudhën korrik - dhjetor 2023

1.1. Prioritetet e Degës penale

Gjatë periudhës gjashtë-mujore, Dega Penale e Gjykatës Supreme e Kosovës ka caktuar prioritetet e saj në analizimin e politikës ndëshkimore për lëndët që lidhen me veprat penale kundër detyrës zyrtare (korrupsioni), dhunën në familje dhe vrasjet e rënda. Gjithashtu, gjyqtarët e Degës Penale janë angazhuar në përpilimin e një përmbledhjeje të praktikave të Gjykatës Supreme, kjo përmbledhje e praktikave të Gjykatës Supreme synon të sjellë konsistencë dhe transparencë në sistemin gjyqësor të Kosovës. Përpilimi i përmbledhjes së praktikave të Gjykatës Supreme në Kosovë ka një rëndësi të jashtëzakonshme për sistemin e drejtësisë. Ky proces sjellë konsistencë dhe transparencë në interpretimin dhe zbatimin e ligjit në gjykatat e instancave të ulëta.

Përmbledhja e praktikave lejon gjyqtarët e degës penale të kenë një udhërrëfyes të qartë dhe të përputhur për rastet specifike, duke iu mundësuar ata të vlerësojnë dhe të vendosin me autoritet në mënyrë të drejtë dhe të barabartë. Kjo përmirëson qartësinë e vendimeve gjyqësore, rrit besimin e publikut në drejtësinë e vendit dhe kontribuon në ndërtimin e një sistemi të fortë të drejtësisë. Përveç kësaj, përpilimi i përmbledhjes së praktikave është një hap drejt harmonizimit të praktikave gjyqësore në sistemin e drejtësisë, duke siguruar që ligji të zbatohet në mënyrë të njëtrajtshme dhe të rregullt në të gjitha nivelet gjyqësore.

Gjykata Supreme ka ndarë punët e grupit punues të cilët do të angazhohen në këtë mënyrë:

- 1) Rastet kur Gjykata Supreme e Kosovës ka anuluar aktvendimet e instancave më të ulëta tek rastet e paraburgimit do t'i trajton gjyqtari **AGIM MALIQI**
- 2) Rastet kur Gjykata Supreme e Kosovës ka ndryshuar aktvendimet e instancave më të ulëta dhe ka ndërprerë paraburgimin do t'i trajton gjyqtari **AGIM MALIQI**
- 3) Rastet kur Gjykata Supreme e Kosovës ka ndryshuar aktgjykimet e instancave më të ulëta, ndërsa të dënuarit janë liruar nga akuza do t'i trajton gjyqtarja **MEJREME MEMAJ**
- 4) Rastet tjera kur Gjykata Supreme e Kosovës ka ndryshuar aktgjykimet penale të instancave më të ulëta do t'i trajton gjyqtarja **MEJREME MEMAJ**
- 5) Rastet kur Gjykata Supreme e Kosovës ka vendosur që të anulon vetëm aktgjykimin e Gjykatës së Apelit të Kosovës dhe kthimin e rastit në rigjykim në gjykatën e shkallës së dytë do t'i trajton gjyqtari **RASIM RASIMI**

6) Rastet kur Gjykata Supreme e Kosova ka vendosur që të anulojë aktgjykimet e instancave më të ulëta dhe kthimin e rastit në rigjykim në gjykatën e shkallës së parë do t'i trajton gjyqtari **AFRIM SHALA**

7) Rastet kur Gjykata Supreme e Kosovës ka konstatuar shkelje të ligjit penal në favor të të pandehurit do t'i trajton gjyqtarja **VALDETE DAKA**

Gjithashtu, grupi punues i gjyqtarëve të Gjykatës Supreme do të angazhohet në hartimin e një përmbledhjeje të rasteve të kthyera në rigjykim nga Gjykata Supreme. Rëndësia e përpilimit të kësaj përmbledhjeje është e jashtëzakonshme për forcimin e sigurisë juridike dhe besimit në sistemin e drejtësisë në Kosovë. Përmbledhja e këtyre rasteve do të mundësonte vlerësimin e koherencës së vendimeve gjyqësore, korrigjimin e gabimeve të mundshme dhe sigurimin e barazisë së trajtimit për të gjithë qytetarët, si dhe në analizën e praktikës së gjykatave të instancave më të ulëta dhe vlerësimin e përputhshmërisë së tyre me ligjin dhe rregullat juridike.

Rekomandimet:

1. Rekomandohet që dega penale të përpiloj buletin të praktikës gjyqësor. Ky buletin duhet të përmbajë analiza të rasteve të rëndësishme dhe vendimeve të Gjykatës Supreme, duke shpjeguar argumentet juridike dhe rregullat që janë zbatuar.
2. Rekomandohet përpilimi i një bulletini të praktikës gjyqësore për rastet e kthyera në rigjykim nga Gjykata Supreme, për të përmirësuar konsistencën dhe transparencën në sistemin e drejtësisë.
3. Pas analizave dhe nxjerrjes së konkluzioneve sa i përket unifikimit të praktikës gjyqësore, dega civile, bashkërisht nxjerr rekomandime për dhënie të mendimeve juridike apo nxjerrje të udhëzuesve përkitazi me gjetjet.
4. Monitorimi i zbatimit të udhëzuesve dhe politikave ndëshkimore: Është e nevojshme që dega penale të monitorojë zbatimin e udhëzuesve për Politikën Ndëshkimore, Udhëzuesin për korrupsionin zyrtar dhe veprat penale kundër detyrës zyrtare, si dhe Udhëzuesin e Gjykatës Supreme për cilësimin dhe trajtimin e rasteve të Dhunës në familje. Duke vlerësuar praktikën e tyre dhe duke i përditësuar ato sipas nevojave aktuale, dega penale do të sigurojë zbatimin e drejtë dhe konsistent të politikave ndëshkimore për të gjitha rastet në fushën e saj të veprimtarisë.

Këto rekomandime kanë për qëllim të përmirësojnë kualitetin dhe harmoninë e vendimeve gjyqësore, duke ndikuar në sigurimin e një sistemi të drejtësisë të efektshëm dhe të besueshëm në Kosovë.

1.2. Prioritetet e Degës Civile

Dega civile, krahas përfundimit të lëndëve me kohë, prioritet do ta ketë, po ashtu, analizimin e praktikës gjyqësore në degën civile, duke nxjerr përmbledhje lidhur me vendimet e spikatura nga dega civile.

Çështjet të cilat do të trajtohen në përmbledhjen e cila do të hartohet nga grupi punues, për periudhën gjashtëmujore:

1. E drejta e parablerjes-zbatimi i ligjit material
2. Ndryshimi i vendimeve për çështje statusore
3. Pasuria e përbashkët e bashkëshortëve
4. Cenimi i pjesës së domosdoshme
5. Vërtetimi i pronësisë nga baza e trashëgimisë
6. Renta
7. Shpronësimi
8. Mungesa e arsytimit ligjor të vendimeve
9. Zotësia për të qenë palë në procedurë dhe përfaqësimi
10. Caktimi i ekspertizave dhe super-ekspertizave në kundërshtim me dispozitat e LPK-së
11. Mungesa e shqyrtimit paraprak të padisë
12. Kontestet e punës, lejueshmëria dhe afatshmëria e padisë
13. Mjetet e jashtëzakonshme juridike në rastet e shkurorëzimit
14. Hedhja e mjeteve të jashtëzakonshme juridike
15. Vërtetimi i gabuar i gjendjes faktike si pasojë e aplikimit të gabuar të së drejtës materiale dhe shkeljeve të dispozitave të LPK-së.

Këto tema të paraqitura janë prioritete të degës civile për periudhën 6-mujore dhe shqyrtojnë çështje të rëndësishme dhe komplekse në sistemin gjyqësor. Secila prej tyre ka pasur dilema dhe vendimmarrje të ndryshme nga gjykatat e instancave më të ulëta, duke sjellë konsistencë të papërshtatshme në praktikën gjyqësore. Për shembull, në disa raste, ka pasur ndryshime në vlerësimin e disa rregullave ligjore, si në anulimin e kontratave ose testamenteve për shkak të cenimit të pjesës së domosdoshme. Gjithashtu, tema të tjera trajtojnë çështje të pronësisë, të drejtave në trashëgim, të përfaqësimit në gjykatë, dhe të vlerësimit të gjendjes faktike. Shqyrtimi i këtyre temave synon të ndihmojë në rregullimin dhe unifikimin e praktikës gjyqësore, për të siguruar konsistencë dhe siguri juridike për qytetarët dhe institucionet gjyqësore në Kosovë.

Rekomandimet:

- a) Pas analizave dhe nxjerrjes së konkluzioneve sa i përket unifikimit të praktikës gjyqësore, dega civile, bashkërisht nxjerr rekomandime për dhënie të mendimeve juridike apo nxjerrje të udhëzuesve përkitazi me gjetjet.
- b) Krahas nxjerrjes së analizave për vendimet e caktuara si më lartë, Dega civile identifikon çështje që mund të ndërlidhen me të drejtat e grave, ndarjen e pronës, trashëgimisë, koordinon të dhënat dhe sipas nevojës, mbështet grupin punues të degës penale në analizimin e rasteve të dhunës në familje dhe nxjerrjen e analizave të përbashkëta.
- c) Rekomandohet që dega civile të përpiloj buletin të praktikës gjyqësor. Ky buletin duhet të përmbajë analiza të rasteve të rëndësishme dhe vendimeve të Gjykatës Supreme, duke shpjeguar argumentet juridike dhe rregullat që janë zbatuar.

1.3. Prioritetet e Degës Administrative

Edhe në degën administrative, krahas zgjidhjes së çështjeve, caktohet grupi punues, i cili udhëhiqet nga gjyqtari Nebojsa Boricic, dhe e ka për obligim që të analizojë praktikën gjyqësore, pa u kufizuar vetëm në rastet që shqyrton, por duke shqyrtuar mundësinë që të kërkojë vendime edhe nga gjykatat e shkallëve më të ulëta, varësisht prej nevojës, në koordinim me administratoren e gjykatës.

Rekomandimet

Sikurse degët tjera, edhe dega administrative, rekomandohet të përpilojë udhëzues, sipas nevojës, për unifikim të praktikës gjyqësore në lëndët administrative.

II. Komisioni Konsultativ për Politikë Ndëshkimore

Komisioni këshillëdhënës për politikë ndëshkimore, i formuar në gusht të vitit 2018, mision të veçantë ka zhvillimin dhe monitorimin e politikës ndëshkimore në vend.

Ky komision do të vazhdojë aktivitetet dhe angazhimin në unifikimin e politikës ndëshkimore edhe gjatë këtij viti dhe do të përkrahet nga Ambasada e SHBA-së në Kosovë dhe UNDP.

Gjatë vitit 2023, pritet të bëhet revidimi i Udhëzuesit për Politikë Ndëshkimore. Ky komision në gjashtë mujorin e parë të vitit 2023 ka funksionuar më këtë përbërje.

Gjatë vitit 2023, Komisioni ka funksionuar në përbërjen si në vijim:

1. Enver Peci, Kryetar i Gjykatës Supreme- Kryesues i Komisionit
2. Agron Qalaj, Prokuror në Zyrën e Kryeprokurorit të Shtetit deleguar nga Kryeprokurori Aleksandër Lumezi

3. Agim Maliqi, Gjyqtar në Gjykatën Supreme- anëtar
4. Burim Ademaj, Gjykata e Apelit,
5. Albina Shabani Rama, Kryetare e Gjykatës Themelore Prishtinë.
6. Enver Fejzullahu, Drejtor i Akademisë së Drejtësisë- anëtar
7. Behar Ejupi, Kryetar i Odës së Avokatëve- anëtar.

Pas dorëheqjes nga pozita e kryetarit të Gjykatës Supreme të z. Enver Peci, dorëheqjes nga anëtari i këtij komisioni z. Burim Ademi, ky komision gjatë gjashtëmujorit të ardhshëm, në bashkëpunim me Ambasadën e SHBA-së, do të plotësohet me anëtarë të rinj.

Komisioni, gjatë punës së tij këtë vit, mund të shërbehet edhe me të dhënat, analizat, rekomandimet e grupeve punuese të degëve të gjykatës, të krijuara për këtë qëllim – politikën ndëshkimore.

III. Bashkëpunimi me institucionet tjera

Gjatë periudhës gjashtë-mujore të ardhshme, Gjykata Supreme e Kosovës planifikon të vazhdojë të ketë një bashkëpunim të mirëfilltë dhe të ngushtë me institucionet e drejtësisë dhe organizatat relevante. Gjykata Supreme do të vazhdojë bashkëpunimin e saj të mirëfilltë me Këshillin Gjyqësor të Kosovës, Ministrinë e Drejtësisë, Kuvendin e Republikës së Kosovës, Gjykatën Kushtetuese dhe Policinë e Kosovës. Në të njëjtën kohë, bashkëpunimi me Ambasadën Amerikane në Prishtinë dhe organizatat joqeveritare vendore dhe ndërkombëtare si USAID, UNDP, OSBE, ROLAG, IKD, BIRN, GLSP, CLARD etj., vazhdon të jetë i rëndësishëm për Gjykatën Supreme.

Në këtë kontekst, Gjykata Supreme planifikon të zhvillojë takime, konferenca dhe aktivitete të tjera me qëllim të përmirësimit të sundimit të ligjit në vend, shqyrtimit të çështjeve gjyqësore dhe politikës ndëshkimore, si dhe ngritjes së transparencës dhe llogaridhënies në sistemin gjyqësor.

Gjykata Supreme në koordinim me KGJK-në, ka marrë përsipër organizimin e Konferencës së Krerëve të Drejtësisë të Evropës Qendrore dhe Lindore, e cila do të mbahet në fillim të qershorit 2024. Ndërsa, gjatë këtij viti në koordinim me gjyqtarin amerikan John Walker dhe institutin CEELI, do të mbahet takimi virtual lidhur me organizimin e kësaj konference, me qëllim të organizimit sa më të mirë të saj. Po ashtu do të fillohet me përgatitjet tjera për organizimin e kësaj ngjarje.

Në të njëjtën linjë, Gjykata Supreme ka në plan të zhvillojë një projekt në bashkëpunim me Bankën Botërore, i cili synon të analizojë dhe pasqyrojë gjendjen e sistemit të drejtësisë në vend. Ky projekt ka për qëllim të përfshijë qytetarët dhe të gjitha institucionet e drejtësisë për të bërë një vlerësim të detajuar dhe të përmbledhur të sistemit të drejtësisë dhe për të identifikuar fushat ku ka nevojë për përmirësim. Kjo bashkëpunim me Bankën Botërore do të kontribuojë në avancimin dhe forcimin e sistemit të drejtësisë në Kosovë.

Bashkëpunimi i fortë dhe i gjerë i Gjykatës Supreme me institucionet dhe organizatat relevante është thelbësor për të siguruar sundimin e ligjit, pavarësinë gjyqësore dhe besimin e publikut në drejtësi. Gjykata Supreme do të vazhdojë të bëjë analiza të rregullta të praktikës së saj dhe të publikojë buletine të praktikës gjyqësore për të ndarë përvojën dhe të kontribuojë në rritjen e efikasitetit dhe cilësisë së vendimeve gjyqësore. Ky proces i përpilimit të buletineve të praktikës gjyqësore do të ndihmojë në përmirësimin e përgjithshëm të sistemit të drejtësisë në Kosovë dhe në forcimin e besimit të publikut ndaj drejtësisë.

Përfundimi

Gjatë disa viteve të fundit, Gjykata Supreme ka gëzuar mbështetjen e Ambasadës Amerikane në Kosovë në analizimin e politikës ndëshkimore dhe përpilimin e udhëzuesve për këtë çështje. Kjo bashkëpunim do të vazhdojë edhe në vitin aktual dhe përfshin një bashkëpunim të ngushtë me Komisionin Konsultativ për Politikë Ndëshkimore, i udhëhequr nga kryetari i Gjykatës Supreme.

Në këtë drejtim, kryetari i Gjykatës Supreme ka planifikuar që gjyqtarët e kësaj gjykate të japin një kontribut shtesë duke kryer analiza dhe hartuar buletine për çështjet e kthyer në rigjykim nga Gjykata Supreme, si dhe buletine për praktikën gjyqësore të Gjykatës Supreme, duke përfshirë vendimet nga viti 2018.

Ky angazhim shtesë i gjyqtarëve të Gjykatës Supreme do të ndihmojë në avancimin e sistemit gjyqësor në Kosovë dhe në forcimin e sigurisë juridike dhe besimit në institucionet e drejtësisë. Përmes analizës së thellë dhe prezantimit të vendimeve në mënyrë të përgjegjshme dhe të qartë, Gjykata Supreme shpreh përkushtimin e saj ndaj sundimit të ligjit dhe përparimit të drejtësisë në vend.

Me përpjekje të përbashkët, Gjykata Supreme shpreh përkushtimin e saj ndaj sundimit të ligjit, drejtësisë dhe sigurisë juridike në vend, duke e bërë sistemin gjyqësor në Kosovë më të fortë, më i besueshëm dhe më i integruar me standardet ndërkombëtare.

Ky plan dhe program mund të ndryshohet dhe plotësohet nga kryetari i gjykatës varësisht nga nevojat për organizimin më efektiv të punëve, zgjidhjen më efikase të lëndëve dhe në rast të ndryshimit të numrit të gjyqtarëve dhe strukturës së gjykatës.

Ky plan i punës dhe programi për zgjidhjen efikase të lëndëve, zbatohet nga 3 korrik 2023.

Obligohet Zyra për Informim, të publikoj këtë plan/program në ueb faqen e gjykatës.

Fejzullah Rexhepi

Datë: 26 korrik 2023

Kryetar i Gjykatës Supreme

Me këtë plan do të njoftohet:

Këshilli Gjyqësor i Kosovës